



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 315 Prot

Tiranë, më 14 01 2020

UDHËZIM

Nr. 1 datë 14.01 2020

PËR

**DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE
MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE,
NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN
OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

U D H Ë Z O J :

KREU I

**HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË**

**A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI TË
ARSIMIT TË LARTË**

1. Subjekti juridik vendas ose i huaj aplikon në sistemin elektronik përkatës pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim MASR, duke ngarkuar aplikimin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 1 pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, brenda datës 15 maj për vitin akademik pasardhës.
2. MASR brenda një afati 30 ditor nga data e aplikimit, njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

3.1. Dokumentacioni ligjor;

- a) Ekstrakti i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ose vendim regjistrimi nga gjykata kompetente për subjektin juridik, ku të jetë përfshirë arsimi i lartë në objektin e veprimtarisë së tij.
- b) Jetëshkrimet e administratorit dhe ortakut/ëve të shoqërisë.
- c) Deklarata që subjekti, administratori dhe ortakut/ët nuk janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3.2 Dokumentacioni për plotësimin e standardeve akademike dhe të organizimit të IAL-së;

- a) Projekt-statuti i institucionit të arsimit të lartë (në vijim IAL) ku përcaktohen detyrimisht strukturat dhe kërkesat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- b) Lista e stafit akademik dhe ndihmës akademik sipas njësive kryesore/njësive bazë ku do të atashohen. Njësia bazë duhet të plotësojë kushtin që të ketë në përbërje të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë, ndër të cilët, të paktën tre, me gradë shkencore ose titull akademik. Njësia bazë për Kolegjin Profesional të Lartë duhet të ketë në përbërje të paktën 5 (pesë) anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel mësimdhënës nga të cilët, të paktën 1 (një) me gradë shkencore ose titull akademik.
- c) Kopje të dëshmimeve të titujve akademikë dhe gradave shkencore, për kategoritë “Profesor” dhe “Lektor”, kopje të diplomës “Master i shkencave” për kategorinë “Asistent lektor”.
- d) Aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin me kohë të plotë nënshkruar nga autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë.

3.3 Dokumentacioni për programet mësimore;

- a) Rregullorja e programit të studimit.
- b) Plani mësimor për çdo program studimi të propozuar, ku përcaktohen fusha përkatëse e arsimit, lëndët e ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe ngarkesa mësimore e personelit akademik të angazhuar.
- c) Planet lëndore (syllabus-et) përkatëse me firmën e titullarit të lëndës/pedagogut të lëndës (për programet profesionale). Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.
- d) Kopje të marrëveshjes kuadër dhe dokumentit të akreditimit të institucionit bashkëpunues, në rastin e ofrimit të një programi të përbashkët studimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendës ose të huaj.
- e) Numri i studentëve që parashikohet të regjistrohen në programet e studimit në rast hapje të IAL-së, i nevojshëm për vlerësimin e standardit mbi raportin personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, parashikuar në VKM nr.418/2017 “Për

standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.

f) Listën e titullarëve të lëndëve.

3.4 Dokumentacioni financiar;

- a) Plani financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara mbi veprimtarinë që do të kryejë.
- b) Deklaratë mbi burimet e financimit.
- c) Vërtetim bankar me anë të së cilës subjekti garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përlogaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit.
- d) Mandat pagesë prej 30% të shumës së tarifës bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të llojit të IAL-së, parashikuar në tabelën 2/a, të vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar.

3.5 Dokumentacioni për normativat dhe infrastrukturën;

- a) Kopje të noterizuar të certifikatës së pronësisë së godinës ose kontrata e qirasë/huapërdorjes me afat jo më pak se 3 vjet, shoqëruar me kopje të njësuar të certifikatës së pronësisë së qiradhënësit.
- b) Relacion mbi infrastrukturën e godinës nga eksperti i licencuar, ku detajohen ambientet minimale të nevojshme për hapjen e IAL-ve, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, që janë si më poshtë:
 - i. auditorë mësimi;
 - ii. laboratorë për programin studimit dhe ndjekje praktikash;
 - iii. ambiente për personelin akademik;
 - iv. ambiente për personelin administrativ;
 - v. bibliotekë dhe ambiente për senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj.;
 - vi. ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës si kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike, etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara.
- c) Leja higjieno-sanitare dhe akti për mbrojtjen nga zjarri, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen e IAL-së:

- a) Dokumentacioni shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij në MASR. Në rast se konstatohen mangësi në dokumentacion, MASR i kërkon subjektit plotësimin e tyre,

brenda afatit kohor prej 15 ditëve nga data e njoftimit. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.

- b) Kur dokumentacioni është sipas kërkesave të këtij udhëzimi, vijon procedura me vlerësimin e plotësimin të standardeve nga ekspertë të jashtëm nga lista e miratuar nga ASCAL, të cilët caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në vijim ministri. Numri i ekspertëve për vlerësimin paraprak institucional, tarifatat që paguhet nga IAL-të, si dhe masa e pagesës së ekspertëve, përcaktohen në VKM-në nr.109/2017, të ndryshuar.
- c) Ekspertët brenda 21 ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, MASR njofton subjektin i cili bën plotësimet e nevojshme brenda 21 ditëve nga marrja e njoftimit.
- d) Nëse pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet nga subjekti brenda këtij afati, prezumohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- e) Dokumentacioni me plotësimet i depozituar nga subjekti i përcillet ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësuar. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministri i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

A.1 LEJA E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, MASR vijon me procedurën e hapjes së programeve të studimit. Pas hapjes së programeve të studimit MASR kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Pas verifikimeve, hartohet raporti dhe i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin dhe në rast miratimi nga ministri, nxirret urdhri për fillimin e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon aplikimin në sistemin elektronik përkatës, për riorganizimin e IAL-së sipas shtojcës nr.1, brenda datës 15 tetor për vitin akademik pasardhës, i cili shqyrtohet në MASR.
2. MASR brenda një afati 15 ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.
3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, subjekti brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për miratimin e riorganizimit të IAL-së;
 - b) projekt-statutin për llojin e IAL-së së riorganizuar;

- c) organigramën ekzistuese dhe atë të propozuar për riorganizimin e IAL-së;
- d) aktet e hapjes dhe akreditimit të IAL-së;
- e) plan-biznesin për riorganizimin e llojit të IAL-së;
- f) deklaratën mbi burimin e financimit ku të argumentohet mbulimi i shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë akademike;
- g) listën e programeve të studimit që do të ofrohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë;
- h) listën e personelit akademik me kohë të plotë sipas njësive kryesore dhe dokumentacioni që vërteton shkollimin dhe kualifikimet;
- i) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të IAL-së sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 418, datë 10.05.2017. Kjo deklaratë shoqërohet me dokumente që vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të mjediseve dhe plotësimin e kriterëve infrastrukturore, për një periudhë jo më pak se 3 vite;
- j) mandat pagesën prej 30% të shumës së parashikuar për vlerësimin e jashtëm të llojit të IAL-së sipas përcaktimeve në VKM-në nr.109/2017, të ndryshuar.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për riorganizimin e IAL-së:

- a) Dokumentacioni shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e depozitimit në MASR. Në rast se konstatohen mangësi, MASR i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda një afati 15 ditor. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- b) Në rast të vlerësimit pozitiv, dokumentacioni i kalon për shqyrtim ekspertëve të jashtëm të fushës për vlerësimin institucional, përzgjedhur nga lista e ASCAL-it, caktuar me urdhër të ministrit.
- c) Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur ekspertët vlerësojnë se dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR njofton subjektin për plotësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga marrja e raportit të vlerësimit.
- d) Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, presumohet që subjekti ka hequr dorë nga kërkesa dhe praktika arkivohet.
- e) Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit nga ekspertët e jashtëm për vlerësimin institucional, ministri miraton me urdhër riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë.

C. PEZULLIMI I VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

- 1. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së IAL-së bazuar në raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.
- 2. Pezullimi i veprimtarisë së IAL-së, mund të jetë pezullim i gjithë veprimtarisë, si dhe pezullim i veprimtarisë së degëve apo njësive kryesore përkatëse, për një afat jo më të gjatë se dy vjet, duke i hequr të drejtën për të regjistruar studentë, deri në momentin e heqjes së pezullimit.

3. Pezullimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

D. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

I. Mbyllja me kërkesë të IAL – së;

1. Mbyllja e institucionit të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave mbi bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin, mbështetur në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon elektronikisht në sistemin elektronik dhe në mënyrë shkresore dokumentacionin për mbylljen e IAL- së.
2. Afati i fundit i depozitimit të dokumentacionit nga IAL-ja, është 6 muaj para përfundimit të vitit akademik. Dokumentacioni duhet të përmbajë:
 - a) kërkesën e argumentuar;
 - b) propozimin e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për mbylljen e IAL-së;
 - c) deklaratën për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe taksave vendore, shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucionet përgjegjëse;
 - d) deklaratën mbi masat e marra për përfundimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve të IAL-së;
 - e) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve të IAL - së që nuk kanë përfunduar studimet;
 - f) deklaratën për përmbushjen e të gjithë detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të IAL-së.
3. Dokumentacioni i depozituar shqyrtohet në MASR, e cila brenda 30 ditëve njofton IAL-në për plotësim apo saktësim të dokumentacionit.
4. Nëse dokumentacioni vlerësohet i plotë, MASR i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e IAL-së.

II. Mbyllja e IAL-ve me nismën e MASR;

1. Mbyllja e IAL-së bëhet me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin në rastin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.
2. MASR njofton paraprakisht Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit, të cilët brenda 30 ditëve nga data e njoftimit shprehin mendimin e tyre.
3. Bazuar në raportet për kontrollin e ligjshmërisë, auditimit apo akreditimit, shoqëruar me provat që faktojnë shkeljet e konstatuara, ministri merr vendim nëse për IAL-në do të propozojë mbylljen pranë Këshillit të Ministrave apo do të vendosë masën e ndërmjetme të pezullimit të veprimtarisë së IAL-së, deri në një vendimmarrje përfundimtare.

E. BASHKIMI OSE NDARJA E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Institucioni/et për arsimin e lartë ngarkojnë në sistemin elektronik përkatës pranë MASR aplikimin për bashkimin ose ndarjen e IAL-ve, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.
2. Afati i fundit i depozitimit për aplikimit nga IAL-të është data 15 tetor për vitin akademik pasardhës.
3. MASR brenda një afati 15 ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.
4. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të IAL-ve përkatëse për ndarjen ose bashkimin e tyre;
 - b) emërtimin e IAL-së/ve të krijuara;
 - c) dokumentacionin mbi veprimet e kryera në ortakërinë e re të krijuar në rastin e bashkimit të IAL-ve jo publike;
 - d) vendimet e organeve dhe autoriteteve drejtuese të IAL-së/ve të përfshirë;
 - e) planin paraprak të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në rastin e ndarjes ose marrëveshjen paraprake të miratuar nga Senatet Akadematike dhe Bordet e Administrimit në rastin e bashkimit;
 - f) organigramat, statutet, rregulloret ekzistuese dhe ato të propozuara, si rrjedhojë e ndarjes/bashkimit të IAL-së/ve;
 - g) lista e programeve të studimit që do të ofrohen nga IAL-të, të ndarë sipas njësive kryesore dhe bazë, pas përfundimit të procedurës së ndarjes apo bashkimit;
 - h) personelin akademik, me kohë të plotë, në funksion të programeve të studimit dhe aktmarrëveshjet/kontratat me ta;
 - i) relacionin nga një ekspert i licencuar, lidhur me ndryshimet infrastrukturore në godinë dhe në mjedise të reja mësimore që nevojiten pas ndarjes/bashkimit;
 - j) relacionin mbi efektet financiare që do të lindin pas ndarjes/bashkimit.
5. Pas shqyrtimit të plotësisht të standardeve dhe kriterëve për bashkimin apo ndarjen e IAL-së, në rast se konstatohen mangësi, brenda 21 ditëve duhet të hartohet raporti i verifikimit me vërejtjet përkatëse dhe njoftohet IAL-ja për plotësim/saktësim dokumentacioni. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, brenda një afati 15 ditor, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
6. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, MASR i propozon Këshillit të Ministrave bashkimin/ndarjen e IAL-së/ve.
7. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e bashkimit/ndarjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ministri miraton me urdhër fillimin e veprimitarisë së IAL-së/ve.

KREU II

HAPJA DHE MBYLLJA E DEGËVE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Dega e institucionit të arsimit të lartë, vendase ose e huaj, është:
 - a) pjesë përbërëse e njërive të selisë qendrore të institucionit;
 - b) njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë, si njësi kryesore ose njësi bazë.
2. Afati i aplikimit nga IAL-të është deri më datë 15 tetor për vitin akademik pasardhës.
3. Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që duan të hapin degë të tyre në Republikën e Shqipërisë duhet të ngarkojnë elektronikisht aplikimin sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.
4. Në rast të miratimit të aplikimit, IAL-të ngarkojnë elektronikisht dhe depozitojnë në formë shkresore, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokumentacionin për përmbushjen e standardeve akademike, normativave dhe infrastrukturës, siç parashikohet në këtë udhëzim.
 - b) Vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Për IAL-të e huaja vendimet e organeve përkatëse të saj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
 - c) Plan-biznesin për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë së tyre akademike.
 - d) Vetëdeklarimin për burimin e financimit dhe vërtetimin bankar.
 - e) Aktin e hapjes/riorganizimit dhe aktin e akreditimit të IAL-së dhe të programeve ekzistuese të studimit, të vendit të origjinës.
 - f) Dokumentacionin përkatës për hapjen e programeve të reja të studimit sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
5. Dokumentacioni i përcaktuar më sipër shqyrtohet nga MASR dhe në rast të vlerësimit pozitiv, nxirret akti i hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe/ose në nivel njësie bazë për institucionet e arsimit të lartë me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj pas aplikimit të fazës së parë.
6. Hapja e degës së IAL-së, si në nivel njësie kryesore si në nivel njësie bazë, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

B. PROCEDURA PËR MBYLLJEN E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

I. Mbyllja e degës me kërkesë të IAL – së.

1. Mbyllja e degëve të IAL-së bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, bazuar në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë. IAL ngarkon në sistemin elektronik përkatës kërkesën dhe dokumentacionin për mbylljen e degës.

2. Afati i fundit i depozitimit të dokumentacionit nga IAL-ja, është 6 muaj para përfundimit të vitit akademik. Dokumentacioni duhet të përmbajë:
 - a) kërkesën e argumentuar;
 - b) propozimin e Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit për mbylljen e degës;
 - c) deklaratën për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe vendore, e shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucioni përgjegjës;
 - d) deklaratën mbi masat e marra për mbarimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve;
 - e) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve që nuk i kanë përfunduar studimet;
 - f) deklaratën për përmbushjen e të gjithë detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve.
3. Pas shqyrtimit të plotësisht të kriterëve për mbylljen e degës së IAL-së, në rast se konstatohen mangësi, brenda 21 ditëve duhet të hartohet raporti i verifikimit me vërejtjet përkatëse dhe njoftohet IAL-ja për plotësim/saktësim dokumentacioni. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, subjekti konsiderohet që ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
4. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, mbyllja e degës/ëve të IAL-së, miratohet me urdhër të ministrit.

II. Mbyllja e degës së IAL-së me nismën e MASR.

1. Mbyllja e IAL-së bëhet me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin në rastin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.
2. MASR njofton paraprakisht Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, të cilët brenda 30 ditëve nga data e njoftimit shprehin mendimin e tyre.
3. Bazuar në raportet për kontrollin e ligjshmërisë, auditimit apo akreditimit, shoqëruar me provat që faktojnë shkeljet e konstatuara, bëhet mbyllja e degës së IAL-së me urdhër të ministrit.

KREU III

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E NJËSIVE KRYESORE TË IAL-SË

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN DHE RIORGANIZIMIN E NJËSISË KRYESORE TË IAL

1. Hapja/riorganizimi i njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të IAL-së, pas miratimit të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.
2. Afati i fundit i aplikimit në fazën e parë është data 15 tetor për vitin akademik pasardhës.
3. Institucioni për arsimin e lartë ngarkon në sistemin elektronik përkatës aplikimin për hapjen/riorganizimin e njësive kryesore, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.

4. MASR brenda një afati 30 ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.
5. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, subjekti brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore.
 - b) Dokumentacionin mbi sipërfaqet e shfrytëzueshme të IAL-së të ndara sipas fushave të studimit që parashikohen në dispozicion të njësisë kryesore që do të hapet, për zhvillimin e veprimtarisë së saj, si dhe çdo dokument që provon përmbushjen e standardeve akademike dhe infrastrukturore për njësinë kryesore që hapet/riorganizohet dhe për njësitë bazë të saj.
 - c) Propozimin për ndryshimet e statutit të miratuar, ku të përcaktohen hapja/riorganizimi i njësisë kryesore, strukturat përbërëse të saj, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese të saj, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çdo ndryshim tjetër i nevojshëm.
 - d) Listën e stafit akademik dhe ndihmës akademik me kohë të plotë ekzistues dhe listën e stafit akademik dhe ndihmës akademik me kohë të plotë të njësisë kryesore të re/riorganizuar, shoqëruar me:
 - i. jetëshkrimet, diplomat, titujt dhe gradat shkencore;
 - ii. kontratat e punës apo aktmarrëveshjet e nënshkruara nga palët.
 - e) Listën e programeve të studimeve ekzistuese të listuara që do të mbulohen/mbështeten nga njësia kryesore.
6. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore të IAL-së:
 - a) Pas shqyrtimit të dokumentacionit në MASR, në rast se konstatohen mangësi, MASR i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda afatit kohor prej 15 ditëve. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
 - b) Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MBYLLJEN E NJËSIVE KRYESORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Kërkesa dhe dokumentacioni për mbylljen e një njësie kryesore ngarkohet në sistemin elektronik përkatës, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të vitit akademik.
2. Dokumentacioni duhet të përmbajë:
 - a) vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për mbylljen e njësisë kryesore;
 - b) deklaratën për masat e marra mbi përfundimin e studimeve nga ana e studentëve të njësisë kryesore përkatëse;

- c) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin përkatës për transferim studimesh të studentëve të njësisë kryesore përkatëse që nuk kanë përfunduar studimet, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
 - d) deklaratën mbi përmbushjen e të gjithë detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të njësisë kryesore përkatëse, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në MASR, në rast se konstatohen mangësi ose në rast pretendimesh nga studentët, brenda 21 ditëve, MASR kërkon pranë subjektit, plotësim apo saktësim dokumentacioni ose dhënie informacioni për plotësimin e pretendimeve. Në rast të mungesës së pretendimeve apo kur dokumentacioni është i plotë, përgatitet raporti për ministrin, i cili miraton me urdhër mbylljen e njësisë kryesore. Organet drejtuese dhe akademike të IAL- së, kanë përgjegjësinë për rregullimin e pasojave që burojnë nga mbyllja e njësisë kryesore, mbi procesin e mësimdhënies dhe sistemimin e studentëve.

KREU IV

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

1. IAL-ja ngarkon në sistemin elektronik përkatës aplikimin, sipas shtojcës nr. 2, për hapjen e programeve të studimit, brenda datës 30 shtator për vitin akademik pasardhës.
2. MASR brenda një afati 60 ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.
3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, IAL-ja brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) propozimin e njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit;
 - b) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);
 - c) mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM nr. 109/2017, të ndryshuar;
 - d) listën e plotë emërore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;
 - e) dosja e personelit përmban:
 - i. kontratat e punës me personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë në rast të hapjes së programit, ose vërtetim nga rektori mbi kategorinë e personelit akademik, dhe kohëzgjatjen e kontratës me ose pa afat të caktuar;
 - ii. dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);

- iii. letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme;
 - iv. lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;
 - v. me përjashtim të personelit akademik nga një IAL e huaj, në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit, ose të zotërojë dëshmi për nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive në të cilën do të ofrohet programi, vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.
4. Në rast se IAL-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, të depozitohet:
- a) relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrit ligjor në fuqi (shoqëruar me kopjen e njësuar me origjinalin të licencës së këtij të fundit).
 - b) planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën materiale dhe didaktike.
 - c) akti i posedimit të godinës apo kontrata e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, e shoqëruar me vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit.
5. Dokumentacioni mbi programet e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të vendimit nr.41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar, është si më poshtë:
- a) rregullore e programit të studimit;
 - b) plani mësimor për çdo program studimi;
 - c) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale).
6. Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendas ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe noterizuar edhe i dokumenteve si më poshtë:
- a) Akti i akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
 - b) Dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit.
 - c) Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.

d) Lloji dhe modeli i diplomës (e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët), i miratuar nga IAL-të.

7. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen e programeve të studimit:

- a) Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm realizohet në MASR, brenda 21 ditëve nga depozitimi. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- b) Në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertëve të caktuar nga MASR, sipas fushave të ekspertizës dhe të zgjedhur nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar nga ASCAL, të caktuar me urdhër të ministrit. Ekspertët brenda 21 ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet nga ekspertët se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, institucionit i kërkohet plotësimi i tij brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- c) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve, dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika arkivohet.
- d) Pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët, ministri miraton me urdhër hapjen e programit të studimit.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT MBI MASËN 20 % TË SHPREHUR NË KREDITE

1. IAL ngarkon aplikimin, në sistemin elektronik përkatës, sipas shtojcës nr. 2, për riorganizimin e programeve të studimit, brenda datës 30 shtator për vitin pasardhës, i cili shqyrtohet nga MASR.
2. MASR brenda një afati 15 ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.
3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimin e Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit të IAL-së;
 - b) planin mësimor ekzistues dhe planin mësimor të riorganizuar;
 - c) rregulloren e programit të studimit që riorganizohet;
 - d) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari/pedagogu i lëndës (për programet profesionale);

- e) listën e stafit akademik në funksion të programit të studimit dhe formën e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme) shoqëruar me kontratat e punësimit ose vërtetimit të rektorit mbi formën e punësimit të tyre dhe kohëzgjatjen me ose pa afat të caktuar, sipas kategorisë së personelit.
4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për riorganizimin e programeve të studimit mbi masën 20 % të shprehur në kredite:
- a) Shqyrtimi i dokumentacionit bëhet në MASR, brenda 21 ditëve nga data e depozitimit. Në rastet kur konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimin të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- b) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për vlerësim ekspertëve. Ekspertët brenda 21 ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, IAL-së i kërkohet plotësimi i tij, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimin të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.
- c) Në rast plotësimi nga IAL, dokumentacioni i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët brenda 15 ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse arkivohet.
- d) Pas vlerësimit pozitiv përfundimtar të ekspertëve, ministri miraton me urdhër riorganizimin e programit të studimit.
- e) Në rastin kur riorganizimi i programit bëhet nën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite, për programe të akredituara, IAL-ja depoziton pranë MASR, vendimin e Senatit Akademik. MASR-ja njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit akademik. Ndryshimet nën 20% të shprehura në kredite të përmbajtjes së programit të studimit nuk duhet të ndryshojnë emërtesën e programit të studimit, por vetëm ndryshimet profilizuese. IAL-ja nëse është e nevojshme, reflekton ndryshimet në diplomën e lëshuar.

C. PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

1. Akti për hapjen e një programi studimi shfuqizohet në rastet si më poshtë:
- a) IAL-ja i drejtohet ministrit përgjegjës për arsimin me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit të ofruar nga ky institucion jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit të ri akademik. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.

- b) Kur IAL-ja nuk e aktivizon programin brenda dy viteve akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.
 - c) Kur konstatohet mosrespektimi, nga ana e një IAL-je, i kritereve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi.
 - d) Kur IAL-ja nuk ka regjistruar studentë të rinj në programin përkatës të studimit për 2 vite të njëpasnjëshme akademike.
2. Ministri me urdhër, shfuqizon aktin e hapjes së programit ose mbyll programin përkatës të studimit. IAL-ja duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët e regjistruar në programin që kërkohet të mbyllet.
 3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

D. KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGrameve TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, “SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË”

1. Përveç kritereve të përgjithshme të këtij udhëzimi, për hapjen e programeve të ciklit të tretë të studimit “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”, duhet të plotësohen edhe kriteret e posaçme, si më poshtë:
 - a) Të organizohen dhe realizohen nga IAL, të cilat janë të integruara me strukturat shëndetësore universitare ose nga IAL, që kanë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore universitare.
 - b) Strukturat shëndetësore universitare dhe të rrjetit formues duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore, si dhe standardet specifike të programeve të studimit, në të dyja rastet e përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike.
 - c) IAL-të, publike dhe jopublike, vendase ose të huaja, që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit pranë ministrisë, duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar /riakredituar programe të studimit të integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë, të paktën me kohëzgjatje 5-vjeçare (300 ECTS) në programet Stomatologji dhe Farmaci, dhe të paktën 6-vjeçare (360 ECTS), në programin Mjekësi e Përgjithshme.
 - d) Strukturat shëndetësore universitare që janë pjesë integrale e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore universitare, si dhe standardet specifike të programeve të studimit. Të njëjtat kritere dhe standarde specifike duhet të plotësojnë edhe strukturat shëndetësore universitare me të cilat IAL-ja që paraqet kërkesën për hapjen e programeve të studimit, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit.
 - e) IAL-të që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit, duhet të dokumentojnë/verifikojnë paraprakisht që struktura spitalore dhe rrjeti formues që do të angazhohet në secilin program studimi, plotëson kriteret dhe standardet specifike të programeve të studimit.
 - f) Programet e studimit mund të organizohen dhe zhvillohen në bashkëpunim/bashkërisht nga IAL-të të cilat kanë domosdoshmërisht njësi bazë dhe njësi kryesore në fushën e mjekësisë,

mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse, si dhe marrëveshjeve specifike për organizimin e këtyre programeve. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

- g) Për realizimin e programeve të studimit, IAL-të mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me struktura shëndetësore universitare të huaja, të licencuara për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës. Në këtë rast, kërkesa e IAL-së për hapjen e programeve të studimit shoqërohet edhe me statusin ligjor dhe dokumentacionin ligjor të strukturës shëndetësore universitare të huaj për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës, si dhe konfirmimin e këtij statusi nga ministri i MASR-së dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë.
 - h) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me IAL të huaja zbatohen standardet shtetërore të cilësisë të vendit, ku zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë mësimore të programit.
 - i) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore, edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
 - j) Rrjeti formues është përcaktuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve të nxitura nga IAL-të e interesuara.
2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”.
- a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë të angazhuar me punë klinike/diagnostike dhe me tituj akademikë, si profesor, profesor i asociuar ose gradë shkencore doktor/PhD.
 - b) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:
 - i. Personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, me titullin akademik “Profesor”, duhet t’i përkasë fushës së programit të studimit.
 - ii. Personel akademik, i cili ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore.

- iii. Personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.
- c) IAL-të dhe strukturat shëndetësore të rrjetit formues të tyre, sipas kompetencave respektive, përcaktojnë mënyrën e përfshirjes së personelit të strukturave shëndetësore universitare, në zbatimin e programit të studimit.
- d) Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues të programeve të studimeve specializuese afatgjata, i cili zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1). Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të e tjera.
- e) Këshilli drejtues i programit të studimit të specializimeve afatgjata punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit përkatës. Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë të IAL-së, jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi që ofron njësi kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10-vjeçare.
- f) Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit, i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.
- g) Fusha e specializimit të udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Udhëheqësi klinik/tutori ka një eksperiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor". Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik/klinik është 3 (tre).
- h) Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret mendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.
- i) Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.
- j) Specializanti i përfshirë në rrjetin formues merr gradualisht përgjegjësi klinike gjatë specializimit.

- k) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitet bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Ato bëhen publike pas miratimit nga organet drejtuese të IAL-së dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.
- l) IAL-të duhet të përcaktojnë modalitetet e koordinimit dhe gjenerimit të kuotave për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kërkesat të sistemit shëndetësor kombëtar nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.
- m) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”.
- a) Programet e studimit të ciklit të tretë, “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”, përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% të ECTS-ve totale për studime të organizuara teorike, të shpërndara në vite, sipas një plani të studimit.
- b) Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga:
- i. 60% lëndë specifike;
 - ii. 30% lëndë karakterizuese të fushës;
 - iii. 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera;
 - iv. 5% provimi përfundimtar etj.;
 - v. 15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.
- c) Njësia bazë propozuese harton Rregulloren e programeve të studimeve specializuese afatgjata, me anekset specifike për çdo program, në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementet përbërëse të nevojshme për realizimin e programit, dhe ia paraqet Senatit Akademik të IAL-së për miratim. Në rregullore duhet të përcaktohet edhe:
- i. vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike të specializantit, në fund të çdo viti akademik;
 - ii. modalitetet e vlerësimit përfundimtar të specializantit, i cili i nënshtrohet provimit përfundimtar përkatësisht për njohuritë teorike, praktike ose paraqitjes së temës eksperimentale-studimore të diplomës.
- d) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore universitare edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
- e) Për realizimin e programit të studimit, IAL-të garantojnë personelin akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.
- f) Në kuadër të programit të studimit, specializantët caktohen pranë njësive /shërbimeve/reparteve të strukturave shëndetësore universitare, pjesë e rrjetit formues, në

përputhje me planin e studimit të miratuar dhe për kohën e nevojshme për të fituar aftësitë profesionale.

E. KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË”

1. Përveç kriterëve të parashikuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit ofruar nga institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar, duhet të plotësohen edhe kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”, si më poshtë:
 - a) Programet e studimit “Doktoratë” mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “Doktoratë”.
 - b) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kriterëve të përgjithshme të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”.
 - c) IAL-ja depoziton së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit edhe projektet kërkimore-shkencore të financuara, mbi të cilat zhvillohen programet e studimit.
 - d) IAL-ja ofruese e programit të studimit duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendëse apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.
2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”.
 - a) Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga pedagogë me tituj akademikë të kategorisë “Profesorë”.
 - b) Në rastet kur programet e studimit do të kryhen në bashkëpunim/bashkërisht me një IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëheqësi i IAL-së së huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore “Doktor”/PhD.

KREU V KONTROLLET, MASAT DHE ANKIMI

1. Institucionet e arsimit të lartë, si dhe programet e studimit të ofruara prej tyre i nënshtrohen, si rregull, kontrolleve të zbatimit të ligjshmërisë nga MASR të paktën një herë në 3 vjet. Nëse gjatë kontrolleve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, apo të akteve nënligjore, ministrit dhe IAL-së i dërgohet raporti mbi shkeljet e evidentuara.

2. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, IAL dërgon komentet dhe sqarimet e tij në lidhje me raportin.
3. MASR, në raportin përfundimtar pasqyron saktësimet që gjykohen të arsyeshme si dhe qëndrimin përkatës për pjesën e refuzuar të vërejtjeve të institucionit të arsimit të lartë.
4. Pas marrjes së raportit përfundimtar, IAL dërgon një deklaratë të firmosur, (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë, brenda afatit të përcaktuar nga MASR, kriteret e paplotësuara sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi.
5. Në rast se IAL nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, ministri pezullon programin përkatës të studimit deri në përmbushjen e detyrimeve ose nxjerr aktin për mbylljen e programit të studimit.
6. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Kur programi mbyllet me kërkesë të institucionit të arsimit të lartë, paraprakisht duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët në proces.
7. Në të gjitha rastet e refuzimit nga ana e MASR-së, të parashikuara në këtë udhëzim, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë ankimi.
8. Ankimi duhet të paraqitet në MASR jo më vonë se 10 ditë pune nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës.
9. Në rast ankimi nga IAL, ministri i kërkon mendim të argumentuar me shkrim strukturave përgjegjëse në MASR. Në përfundim është ministri i MASR, që vendos pranimin apo refuzimin e aplikimit/kërkesës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

KREU VI

DISPOZITAT TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Shpenzimet e ekspertëve paguhën nga kërkuesi. Numri i ekspertëve, tarifat që paguhën nga IAL-të dhe masa e pagesës së tyre përcaktohen sipas VKM nr.109/2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar.
2. Kur subjekti juridik kërkon të transferojë aktin e hapjes të IAL-së një subjekti tjetër juridik, ai duhet të marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga ministri përgjegjës për arsimin. Subjekti juridik që ka marrë të drejtën, duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe standardet e përcaktuara në VKM nr.418/2017, të cilat verifikohen në vijimësi nga MASR.
3. Udhëzimi nr.11, datë 28.2.2011 “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr.31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”, shfuqizohen.
4. Deri në përgatitjen dhe funksionimin e plotë të sistemit elektronik, shkëmbimi i dokumentacionit

do të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës elektronike zyrtare aplikime.ial@arsimi.gov.al.

5. Përjashtimisht aplikimet për programet e studimit për vitin akademik 2020-2021, do të pranohen deri në 15 shkurt të vitit 2020 dhe shqyrtohen brenda 30 ditëve nga data e aplikimit nga MASR. Subjektet aplikuese të paraqesin dokumentacionin brenda 15 ditëve nga data e vlerësimit pozitiv të aplikimit.
6. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

BESA SHAHINI



SHTOJCA NR. 1

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT PROPOZIM PËR HAPJE/RIORGANIZIM TË NJË INSTITUCIONI TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE, MBYLLJE E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE/RIORGANIZIM I NJËSIVE KRYESORE TË IAL-SË, BASHKIM OSE NDARJE E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË.

<p>1. Institucioni/IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit</p>	<p>2. Aplikimi (zgjidh një):</p> <ul style="list-style-type: none">- Hapje IAL <input type="checkbox"/>- Riorganizim IAL <input type="checkbox"/>- Hapje e degëve të IAL-së <input type="checkbox"/>- Hapje njësie kryesore të IAL-së <input type="checkbox"/>- Riorganizim i njësisë kryesore të IAL-së <input type="checkbox"/>- Bashkim i IAL-ve <input type="checkbox"/>- Ndarje e IAL-ve <input type="checkbox"/>- Mbyllje <input type="checkbox"/>
<p>3. Të dhëna mbi personin e kontaktit:</p> <p>Emër, mbiemër: Pozicioni në IAL: Tel: E-mail:</p>	
<p>4. Deklaratë e administratorit të shoqërisë/titullarit të IAL-së për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>5. Të dhëna mbi aktin e regjistrimit në QKB, si dhe përshkrim i objektit të veprimtarisë.</p>	
<p>6. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.</p>	

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT PËR HAPJE/RIORGANIZIM TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE, MBYLLJE E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE/RIORGANIZIM I NJËSIVE KRYESORE TË IAL-SË, BASHKIM OSE NDARJE E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË.

Kjo shtojcë paraqet një udhëzues/strukturë propozimi i cili duhet ndjekur për të propozuar hapje/riorganizim institucioni të arsimit të lartë (IAL), hapje/mbyllje të degëve të IAL-së, hapje/riorganizim të njësive kryesore të IAL-së, ose bashkim/ndarje të IAL-së për miratim në MASR.

Disa rregulla të përgjithshme:

- Propozimet dorëzohen elektronikisht dhe shkruhen në *Times New Roman* ose *Arial* (12 point font).
- Renditja e shtojcave (nëse ka) në fund të propozimit duhet të ndjekë rendin e referimit të tyre në tekst.
- Dokumentacioni dhe të dhënat që përmenden duhen cituar në mënyrë të plotë. Nëse përfshihet një URL (adresë interneti) sigurohuni që të jetë funksionale dhe lidhet me dokumentin e cituar.
- Propozimi duhet të jetë sa më specifik dhe të dhënat që paraqiten në të duhet të lidhen qartazi me propozimin për shqyrtim nga MASR.
- Elementët përbërës të propozimit, për lehtësi, janë përfshirë si një listë për t'u plotësuar. Gjithsesi, propozimi duhet të jetë i strukturuar si një i tërë dhe të përbëjë një narrativë kohezive dhe të rrjedhshme.
- Projekt propozimi nuk duhet të ketë gabime ortografike/drejtshkrimore e duhet të formatohet sipas udhëzimeve të kësaj shtojcë.

Ky udhëzues/strukturë propozimi shërben për grupin e punës që do të shkruajë propozimin për shqyrtim nga MASR. Edhe pse ky dokument përmban një sërë elementesh që duhet të jenë në propozim, ai nuk është shterues. Në çdo kohë MASR mund të kërkojë dokumentacion shtesë dhe sqarime të mëtejshme të propozimit në kuadër të vendimmarrjes.

- a) Të dhëna mbi institucionin/degën/njësinë kryesore/institucionet (që do të bashkohen ose ndahen):

Ky seksion paraqet një përmbledhje makro të propozimit duke përshkruar se si përputhet me strategjinë dhe misionin e IAL-së si dhe me strategjinë e arsimit, shkencës dhe punësimit në vend.

Seksioni duhet të artikulojë, në mënyrë të detajuar, justifikimin për nismën e propozuar dhe si kjo nismë adreson nevojat lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Ky seksion duhet plotësuar në mënyrë të ngjashme me një aplikim për grant kërkimor. Lexuesi/vlerësuesi duhet të bindet që programi i propozuar adreson probleme reale sidomos për zhvillimin rajonal.

Burime të ndryshme dhe të besueshme evidence duhen paraqitur për të treguar që nisma i shërben nevojave reale të rajonit/vendit. Vetëm burime/të dhëna që mbështesin direkt nevojën e nismës së propozuar duhen përfshirë. Seksioni duhet të sqarojë se çfarë burimesh të veçanta ka institucioni që do të kenë efekt në suksesin e aplikimit (p.sh. qendra studimore, ekspertizë kërkimore, etj.).

Ky seksion duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë që të demonstrojë kërkesën dhe nevojën për nismën e propozuar. Sigurohuni që elementët e mëposhtëm të përfshihen: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Përshkrimi i përgjithshëm i misionit, qëllimit dhe objektivave të strukturës që propozohet të hapet/riorganizohet, bashkohet ose ndahet.
- Analizë e detajuar dhe e bazuar mbi të dhëna empirike dhe të verifikueshme e situatës prej të cilës buron nevoja për masën që subjekti do të ndërmarrë (hapje/riorganizim të IAL-së / hapje e degëve të IAL-së / hapje/riorganizim të njësisë kryesore të IAL-së / bashkim/ndarje të IAL-së).
- Risia që sjell kjo nismë, problematikat që ajo adreson për vetë IAL-në dhe nevoja që përmbush në sistemin e arsimit të lartë në vend.
- Analiza SWOT e aplikimit për hapje/riorganizim të IAL-së / hapje e degëve të IAL-së / hapje/riorganizim të njësisë kryesore të IAL-së / bashkim/ndarje të IAL-së.

b) Personeli akademik dhe ndihmës akademik në funksion të strukturës së propozuar (IAL/degë/njësi kryesore):

Në këtë seksion shtjellohen të dhënat mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar/që do të angazhohet në strukturën e re, duke përfshirë informacion mbi:

- Numrin e personelit akademik sipas njësive bazë (personel me kohë të plotë/pjesëshme).
- Numrin e personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesëshme).
- CV e shkurtuar (e personelit akademik nga IAL që do të angazhohet në strukturën e re (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore) angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj).
- Numrin e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të strukturës së propozuar.

c) Infrastruktura akademike në funksion të IAL-së/degës/njesisë kryesore:

Në këtë seksion shtjellohet informacioni mbi infrastrukturën akademike në shërbim të strukturës së propozuar, duke u fokusuar në:

- Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve.
- Laboratorët dhe mjediset në dispozicion për realizimin e praktikës profesionale.
- Biblioteka, numri i titujve, numri i posteve të leximit, e-librari, etj.
- Zyra për stafin akademik dhe ndihmës akademik.

d) Analizë e tregut të punës:

Ky seksion artikulon mënyrën se si nisma e propozuar i përgjigjet nevojave të tregut të punës, duke përfshirë kërkesën aktuale dhe të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë tre objektivat e mëposhtëm:

- Të identifikojë se si nisma e propozuar rrit aftësitë/mundësitë/potencialin e studentëve për të përfutur aftësi që përputhen me kërkesat e tregut të punës me qëllim punësimin stabil me të ardhura sa më të larta.
- Të identifikojë se si nisma e propozuar përmbush kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës në një periudhë afat-mesme.
- Të identifikojë se si nisma e propozuar përshtatet me, ose përmbush, politikat kombëtare të punësimin dhe zhvillimit.

Sigurohuni që në analizë të përfshihen elementët e mëposhtëm: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Programet e studimit që do të ofrohen nga struktura e propozuar dhe pozicionimi i tyre në lidhje me programet e studimit të ofruar nga IAL të tjera.
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimin në sektorët ku bëjnë pjesë programet e studimit që do të ofrohen nga IAL-ja/dega/njësia kryesore, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtarë, etj.
- Nevoja e papërmbushur e tregut të punës që plotëson IAL/dega/njësia kryesore e propozuar.
- Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës, si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.
- Punësimi potencial i studentëve.
- Marrëveshje/kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

SHTOJCA NR. 2

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT PROPOZIMI PËR HAPJE/RIORGANIZIM PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni/IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit.	2. Aplikimi (zgjidh një): Program i ri _____ Riorganizim programi _____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim. Shkruani emërtimin e plotë të programit.	
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes.	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik. Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit.
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL-të bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit.	
8. Programi ofrohet nga/në: Departamenti i _____ Fakulteti i _____ Kampusi/godina _____	
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit: Emër, mbiemër: Pozicioni në IAL: Tel: E-mail:	
10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
11. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.	

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

Kjo shtojcë paraqet një udhëzues/strukturë propozimi i cili duhet ndjekur për të propozuar hapje/riorganizim programesh studimi për miratim në MASR.

Rregulla të përgjithshme:

- Propozimet dorëzohen elektronikisht dhe shkruhen në *Times New Roman* ose *Arial* (12 point font).
- Renditja e shtojcave në fund të propozimit duhet të ndjekë rendin e referimit të tyre në tekst.
- Dokumentacioni dhe të dhënat që përmenden duhen cituar në mënyrë të plotë. Nëse përfshihet një URL (adresë interneti) sigurohuni që të jetë funksionale dhe lidhet me dokumentin e cituar.
- Elementët përbërës të propozimit, për lehtësi, janë përfshirë si një listë për t'u plotësuar. Gjithsesi, propozimi duhet të jetë i strukturuar si një i tërë dhe të përbëjë një narrativë kohezive dhe të rrjedhshme.
- Të dhënat e paraqitura në projekt-propozim, me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe, duhet të jenë qartësisht të lidhura me hapjen/riorganizimin e programit specifik për të cilin aplikohet.
- Projekt propozimi nuk duhet të ketë gabime ortografike/drejtshkrimore dhe duhet të formatohet sipas udhëzimeve të kësaj shtojcë.

Ky udhëzues/strukturë propozimi shërben për grupin e punës që do të shkruajë propozimin për shqyrtim nga MASR. Edhe pse ky dokument përmban një sërë elementesh që duhet të jenë në propozim, ai nuk është shterues. Në çdo kohë MASR mund të kërkojë dokumentacion shtesë dhe sqarime të mëtijshme të propozimit në kuadër të vendimmarrjes.

a) Të dhëna mbi programin e studimit:

Ky seksion duhet të artikulojë, në mënyrë të detajuar, justifikimin për programin e propozuar dhe se si ky program adreson nevojat lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Ky seksion duhet plotësuar në mënyrë të ngjashme me një aplikim për grant kërkimor. Lexuesi/vlerësuesi duhet të bindet që programi i propozuar adreson probleme reale sidomos për zhvillimin rajonal.

Burime të ndryshme dhe të besueshme evidence duhen paraqitur për të treguar që programi i shërben nevojave reale të rajonit/vendit. Vetëm burime dhe të dhëna që mbështesin direkt nevojën e programit duhen përfshirë. Gjithashtu, ky seksion duhet të sqarojë se çfarë burimesh të veçanta ka institucioni që do të kenë efekt në suksesin e programit (p.sh. qendra studimore, ekspertizë kërkimore, etj.).

Në tërësi, ky seksion duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë që të demonstrojë/provojë kërkesën dhe nevojën për programin. Sigurohuni që të përfshihen elementët e mëposhtëm: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misionit, qëllimit dhe objektivave.
- Lloji i programit, kohëzgjatja, numri i krediteve, etj.
- Njësia bazë / njësia kryesore ofruese e programit të studimit.
- Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit.
- Analiza SWOT e aplikimit për hapje/riorganizim programi.

b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët:

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Kriteret e pranimit në programin e studimit.
- Fusha e studimeve paraardhëse (në rastet e programeve të ciklit të dytë).
- Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.
- Tarifa e studimit.
- Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).
- Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.

c) Plani mësimor/Kurrikula e programit të studimit:

Ky seksion përmban/paraqet një analizë të detajuar, të bazuar në evidenca, të kurrikulës së programit duke provuar/argumentuar mënyrën se si kërkesat ligjore dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë janë reflektuar në program.

Gjithashtu, ky seksion duhet të tregojë, bazuar në evidenca, se si kurrikula e programit të propozuar ndryshon nga programet e tjera të ngjashme, adreson boshllëqe potenciale në ofertën akademike për studentët, dhe adreson gjetjet/përfundimet e analizës së tregut të punës.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Numri total i krediteve.
- Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurrikulës dhe krediteve si më poshtë:
 - o Lëndë të përgjithshme.
 - o Lëndë karakterizuese.
 - o Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese.
 - o Lëndë plotësuese.
- Praktika profesionale.
- Detyrime përmbyllëse.
- Tema e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar.

c) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë me programin e studimit, duke përfshirë informacion mbi:

- Numrin e personelit akademik në njësinë bazë.

- Numrin e personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesëshme).
- Numrin e personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesëshme).
- CV-të e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.
- Numrin e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.
- Nëse programi i propozuar është inter-disiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera.

d) Infrastruktura akademike në funksion të programit:

Ky seksion përmban informacion të përmbledhur mbi infrastrukturën akademike në shërbim të programit të studimit, duke u fokusuar në:

- Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve.
- Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.
- Bibliotekë, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library (nëse ka), etj.
- Zyrën për stafin akademik dhe ndihmës akademik.

e) Programet e Përbashkët:

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mëposhtëm:

- Burimet financiare.
- Kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/e shumëfishtë).
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

f) Analizë e tregut të punës:

Ky seksion artikulon mënyrën se si programi i propozuar i përgjigjet nevojave të tregut të punës duke përfshirë kërkesën aktuale dhe të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë tre objektivat e mëposhtëm:

- Të identifikojë se si programi i propozuar rrit aftësitë/mundësitë/potencialin e studentëve për të përfutur aftësi/njohuri që përputhen me kërkesat e tregut të punës me qëllim punësimin stabil me të ardhura sa më të larta.
- Të identifikojë se si programi i propozuar përmbush kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës në një periudhë afatmesme.
- Të identifikojë se si programi i propozuar përshtatet me, ose përmbush, politikat kombëtare të punësimit dhe zhvillimit.

Sigurohuni që në analizë elementët e mëposhtëm të përfshihen: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapje/riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtarë, etj.
- Nevoja e papërmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/riorganizuar i propozuar nga IAL-ja.
- Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.
- Punësimi potencial i studentëve.
- Marrëveshje/kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.